



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË

Nr 7076 Prot

Divjakë më 24 / 09 /2024

Lënda:

N J O F T I M

“PËR DOKUMENTAT E BURSAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR, 2024-2025.

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “ *Për Vetëqeverisjen Vendore* ”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave **nr 666, datë 10.10.2019**, pika 7, “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, **Vendim Nr. 511, Datë 27.7.2022** “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 666, Datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave e të pagesave për nxënësit e Arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike*”, të ndryshuar.

Njoftojmë :

Nxënësit, të cilët do të ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional për vitin shkollor 2024-2025 në **Kërkesën e tyre** për Bursa **duhet të sigurojnë këto dokumenta:**

- 1.Çertifikatë Familjare.
- 2.Fotokopje e Kartës së Identitetit (nëse ka mbushur moshën) ose Çertifikatë personale me fotografi.
- 3.Dëftesë e vitit, të fundit të Shkollës(K1.9-të) fotokopje.
- 4.Vërtetim që vazhdon studimet në vitin e parë akademik 2024-2025, nga Drejtorja e Shkollës së Mesme Profesionale.(Origjinale).
- 5.Vërtetim nëse familja trajtohet me ndihmë ekonomike, njëri nga prindërit është invalid, nxënësi ka statusin e jetimit,kur prindi ka qënë punonjës policie dhe ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës,
- 6.Vendim gjykate të formës së prerë për nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore.

Nxënësit që të Përfitojnë bursë të plotë duhet të plotësojnë këto kriterë:

- a) Nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre,që plotësojnë **kriterin ekonomik.**
- b) Nxënësit e arsimit profesional,të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare 9 (nëntë) deri në 10(dhjetë). që plotësojnë **kriterin e rezultateve të arritura.**

Kriteri jo ekonomik.

- c) Nxënësit të cilët kanë përfutuar statusin e Jetimit.
- d) Nxënësit të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë.
- e) Nxënësit ,të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.
- f) Nxënësit të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë.
- g) Nxënësit ,fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;
- h) Nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
- i) Nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qënieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror.
- j) Nxënësit fëmijë të Punonjësve të Policis së Shtetit,Gardës së Republikës,Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga zjarri dhe të Shpëtimit,Forcave të armatosura,Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policis së Burgjeve etj, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.
- k) Nxënëset (Vajza) të cilat ndjekin drejtimet mësimore: mekanike,elektroteknikë, elektronikë,përpunim druri,gjeodezi,shërbim mjete transporti, termohidraulikë;
- g) Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton.

Shënim:Të gjitha dokumentat të dorëzohen tek Zyra e Informacionit,Kati i I-rë tek Godina e Bashkisë Divjakë, brenda datës 30.11.2024.

Përgj.Sekt. Juridik .

Andi Bullari

NËNKRYETARI
Eris STAMBOLLIU